



ShKÇAK  
DKRRK  
SCAAK

**EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS  
FINANCIARE**

## **1. Përshkrimi i programit “Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare”**

Krizat e fundit financiare kanë theksuar nevojën për profesionistë më të kualifikuar në lëminë e forenzikës financiare. Rrjedhimisht, kërkesa për profesionistët me ekspertizë në luftimin e korrupsionit, mashtrimin ekonomik dhe të kontabilitetit të forenzikës financiare është çdo herë e në rritje.

Ekspertët e Licencuar të Forenzikës përshpejtojnë ritmin e hetimeve dhe sigurojnë një numër më të madh të dënimeve të suksesshme të korrupsionit dhe rasteve të krimit financiar. Pas trajnimit dhe çertifikimit, qëllimi i këtij programi është të promovojë kapacitetet lokale në parandalimin dhe hetimin e krimeve financiare.

Me mbështetjen në teknologjinë e re informative, roli i Ekspertëve të Licencuar të Forenzikës Financiare është zgjeruar në botën digjitale. Informacioni i ruajtur në internet, pavarësisht nga fjalëkalimet dhe karakteristikat e tjera të sigurisë, është gjithnjë në një nivel rreziku dhe ekspertët e licencuar të forenzikës financiare kanë zhvilluar aftësitë e duhura për të përfshirë metoda të ndryshme të hetimit që zbatohen në një mjedis digjital gjithnjë në ndryshim.

Eksperti i Licencuar i Forenzikës Financiare heton një gamë të gjerë të krimeve të ndryshme që lidhen me mashtrimet, si në korporata, institucione publike, institucione financiare, kujdes shëndetësor, marketing masiv dhe mashtrimin me letrat me vlerë. Ata po ashtu hetojnë krime të tjera si mosmarrëveshjet e kontratave, pastrimin e parave dhe përvetësimet.

*Përfitimet nga Ekspertët e Licencuar të Forenzikës Financiare përfshijnë :*

### **1- Ndihmë bizneseve në minimizimin e humbjeve**

Përfitimi primar nga ekspertët e të forenzikës financiare është mënyra në të cilën ata mund të ndihmojnë bizneset në minimizimin dhe parandalimin e humbjeve të panevojshme. Veprimtaritë mashtruese dhe mospërputhjet e përgjithshme financiare i kushtojnë komunitetit të biznesit shuma të jashtëzakonshme parash, çdo orë dhe çdo ditë. Ekspertët e forenzikës financiare përkujdesen që kjo mos të lejohet të ndodhë.

### **2- Përmirësimi i efikasitetit**

Ekspertët e forenzikës financiare luajnë një rol kyç në shqyrtimin dhe hetimin e proceseve dhe standardeve aktuale financiare, të cilat mund të ndihmojnë në identifikimin e zgjidhjeve më efektive dhe më efikase. I gjithë procesi është një zbulim i problemeve dhe fushave për t'u përmirësuar në të mirën e biznesit.

### **3- Zvogëlimi i rrezikut nga shpërdorimet**

Duke zbrërthyer në mënyrë proaktive çdo "zbrazëti" të dukshme në standardet aktuale operative financiare, eksperti i forenzikës financiare mund të sigurojë që rreziku i shpërdorimeve të ardhshme të zvogëlohet ndjeshëm. Ekspertët e kësaj fushe janë një rast i mirë i mbrojtjes së interesave të biznesit përpara se të ndodhin veprimtaritë mashtruese.

### **4- Shmangia e problemeve ligjore**

Ballafaqimi me rastet e mashtrimit (të brendshëm ose të jashtëm) mund të jetë shqetësues dhe i kushtueshëm për biznesin. Ekspertët e forenzikës financiare mund të parandalojnë ndodhjen e skenarëve të tillë, duke e parandaluar aktivitetin mashtrues dhe duke i hequr problemet e zbuluara që në zanafillën e tyre.

### **5- Përmirësimi i reputacioni të bizneseve**

Një biznes që e lë veten të hapur ndaj manipulimit dhe mashtrimit është shumë e vështirë për t'u respektuar, besuar dhe punuar me të. Mashtrimi mund ta dëmtojë reputacionin në mënyrë të pariparueshme - prandaj ekspertët e forenzikës financiare, janë shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e reputacionit të bizneseve.

## ***2.1. Kërkesat për tu çertifikuar si 'Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare'***

- *Edukimi*: kandidatët duhet të kenë të kryer së paku shkollimin e mesëm .

- *Edukimi profesional*: kandidatët duhet të ketë ndjekur trajnimin profesional të këtij programi dhe duhet të kenë kryer të gjitha provimet e parapara (Moduli 1 dhe Moduli 2).

- *Përvoja praktike*: kandidatët duhet të kenë së paku 2 vite eksperiencë në kontabilitet, auditim dhe forenzikës financiare. FPP i definon kompetencat specifike për secilën prej fushave.

Përvoja praktike mund të realizohet para ose pas regjistrimit në programin çertifikues por thirrja mund të fitohet vetëm pas arritjes së të gjitha kërkesave të programi çertifikues.

## ***2.2. Edukimi profesional dhe provimet***

Një nga kushtet për tu çertifikuar si Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare është edhe ndjekja e edukimit profesional si dhe kalimi i provimeve të listuara në vijim.

Moduli 1 – Lënda parakualifikuese
Moduli 2 – Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare

**Moduli 1** është lëndë bazike parakualifikuese e cila përfshin njohuri të përgjithshme nga fushat e ndryshme të cilat janë të nevojshme për një ekspert të forenzikës financiare. Ky modul përbëhet nga gjithsej 4 pjesë duke përfshirë:

- Pjesën 1-Kontabiliteti financiar dhe menaxherial;
- Pjesën 2-Tatimet në Kosovë;
- Pjesën 3-Menaxhmenti Financiar; dhe
- Pjesën 4-Auditimi,

Kandidatët i vijnë ligjëratat për të gjitha pjesët por i nënshtrohen një provimi të vetëm duke përfshirë 4 pjesët.

**Moduli 2** ekskluzivisht përqendrohet në punën e ekspertit të forenzikës financiare siç janë zhvillimi i ekspertizës për zbulimin e mashtrimeve, format e ndryshme të mashtrimeve, teknikat e grumbullimit të dëshmimeve dhe përgatitja e provave për proceset gjyqësore etj.

Pas përfundimit të dy moduleve dhe kalimit me sukses të provimeve, kandidatët do të pajisen me certifikatë e cila posedon **48 ECTS kredi**

### **2.3. Fitimi i titullit “Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare” nga anëtarët në ShKÇAK**

Anëtarët ekzistues të Shoqatës mund të fitojnë titullin Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare duke plotësuar këto kushte :

**Teknik Kontabiliteti** – do të fitojnë titullin pasi të dëgjojnë ligjëratat në lëndët “P6-Auditimi” dhe “P7- Menaxhmenti Financiar” të përfundojnë provimin në lëndën “Moduli 2” si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

**Kontabilist i Çertifikuar** - do të përfitojnë titullin pas përfundimit të provimit në lëndën "Moduli 2" si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

**Auditor i Çertifikuar** - do të përfitojnë titullin pas përfundimit të provimit në lëndën "Moduli 2" si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

**Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik** - do të përfitojnë titullin pas përfundimit të provimit në lëndën "Moduli 2" si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

**Auditor i Brendshëm i Çertifikuar** - do të përfitojnë titullin pasi të dëgjojnë ligjëratat në lëndët "P4- Ligjet dhe tatimet në Kosovë" dhe "P7- Menaxhmenti Financiar", të përfundojnë provimin në lëndën "Moduli 2" si dhe përmbushjes së përvojës praktike relevante.

#### **2.4. Kërkesat për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP)**

Për ta mirëmbajtur titullin '*Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare*' ekspertët e forenzikës financiare, duhet të dëshmojnë kryerjen e minimum 12 orë-ve të verifikueshme të edukimit të vazhdueshëm çdo vit prej të cilave:

- minimum 8 orë në fushtat specifike të cilat lidhen direkt me profesionin në forenzikën financiar
- minimum 4 orë EVP që lidhen direkt me etikën

Temat nga fusha specifike të cilat janë të pranueshme për qëllime të EVP-së duhet të jenë nga këto fusha: (i) hulumtimi dhe zbulimi i aktiviteteve mashtruese (ii) shpëlarja e parave; (iii) korrupsioni; (iv) krimet ekonomike; (v) pajtueshmëria me kërkesat që dalin nga ligjet dhe rregullativat; (vi) ekzaminimi i mashtrimeve; (vii) teknikat e intervistimit; (viii) ligjet biznesore; (ix) kompetencat profesionale; (x) konfliktet e interesit; (xi) etika dhe sjellja profesionale ;etj.

EVP ju siguron ekspertëve të forenzikës financiare të mbajnë thirrjen e tyre aktive pasi që certifikata ka validitet 1 vjeçar dhe të njëjtit duhet të dëshmojnë EVP-të e obligueshme në mënyrë që të mund të rinovojnë thirrjen "*Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare*" çdo vit. ShKÇAK do të të promovojë këta ekspertë duke vendosur emrat e tyre në uebfaqen e saj.

Anëtarët aktiv **“Auditorë Ligjorë “** në ShKÇAK obligohen të dëshmojnë minimum 5 orë EVP në fushat specifike të forenzikës financiare (nga totali prej 24 orëve EVP të cilat i kanë të obligueshme), në mënyrë që të mund ta mirëmbajnë thirrjen **“Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare”**.

Anëtarët aktiv **“Kontabilist të Çertifikuar”** në ShKÇAK obligohen të dëshmojnë minimum 5 orë shtesë EVP në fushat specifike të forenzikës financiare në mënyrë që të mund ta mirëmbajnë thirrjen **“Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare”**.

Anëtarët aktiv **“Teknik Kontabiliteti”** në ShKÇAK obligohen të dëshmojnë minimum 8 orë shtesë EVP në fushat specifike të forenzikës financiare si dhe 4 orë EVP në lëminë e etikës dhe sjelljes profesionale në mënyrë që të mund ta mirëmbajnë thirrjen **“Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare”**.

EVP-të mund të mbahen në shoqatat profesionale të cilat janë anëtare të FNK-së, apo në shoqatat/organizatat të cilat janë të autorizuara në atë shtet të ofrojnë EVP. Kandidatët duhet të sjellin çertifikatën e pjesëmarrjes për secilën orë të EVP-së të cilën e kanë mbajtur.